



## Forcimi i Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore në Shqipëri

### Objektivat e projektit

Objektivat afatgjate të këtij projekti synojnë përmirësimin e qeverisjes në nivel lokal. Bashkitë/komunat të qeverisura mirë do jenë në gjendje të ndërmarrin përgjegjësi të reja decentralizimi, dhe kjo si rezultat do të rrisë mundësitë për nxitjen e zhvillimit ekonomik.

### Komponentët e projektit

**Komponent 1:** Vlerësimi i ecurisë së decentralizimit në Shqipëri me objektiv kryesor që t'i japë qeverisjes informacion mbi procesin dhe arritjet e deritanishme dhe një plan veprimi për masa të mëtejshme konstruktive.

**Komponenti 2:** Botimi i një manuali për "Forcimin e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore në Shqipëri", që përfshin Planifikimin Strategjik, Planifikimin Operacional, dhe Planifikimin Financiar, sipas kërkesave e shprehura nga Ministria e Qeverisjes Vendore dhe Decentralizimit. Manuali për "Forcimin e Decentralizimit dhe Qeverisjen Vendore në Shqipëri" është vlerësuar si një kontribut i rëndësishëm që do të ndihmojë qeveritë vendore për të ushtruar autoritetin e tyre në fushat problematike. Manuali është i pari që botohet i këtij lloji. Megjithatë, ne e rekomandojmë këtë manual si një burim që të përdoret në trajnimet e ardhshme për bashkitë, komunat dhe qarqet si dhe



vendimmarrësit e përfshirë në procesin e decentralizimit.

**Komponent 3:** Trajnimi i trajnerëve; një objektiv tjetër imediat ishte forcimi i kapaciteteve organizative të këshillave të qarkut si sigures të trajnimit dhe asistence teknike e shërbime të tjera mbështetëse për bashkitë dhe komunat. Ekspertet e IKU-it dhe SIPU-t organizuan një trajnim për trajnuesit për qeveritë vendore, e karakterizuar nga metodat pjesëmarrëse, me tre zyrtarë rajonale duke përfshirë: Gjirokastër, Fier, Kukës.

### Hapat e projektit

- Identifikimi i nevojave për trajnim të stafit të bashkive dhe të zgjedhurve lokale;
- Përgatitja e programeve dhe manualeve të trajnimit duke u bazuar në nevojat për trajnim;
- Ngritja e kapaciteteve të trajnuesve kombëtar në hartimin dhe ofrimin e

trajnimeve për punonjësit civil në qeverinë qendrore dhe autoritetet e zgjedhura. Përmirësimi apo rishikimi i strategjive rajonale.

### FAKTET KRYESORE

#### PARTNERET:

- ✓ SIPU  
International/UNOPS/UNDP

#### KOHËZGJATIA:

Janar 2003 – Tetor 2004

#### PËRFITUESIT:

- ✓ Zyrtarë raonale në Kukës, Gjirokastër dhe Fier

#### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14  
Hyrja 11, Ap. 56  
Tiranë  
Tel: +355 4 2256840  
E-mail: [uri@uri.org.al](mailto:uri@uri.org.al)  
Web: [www.uri.org.al](http://www.uri.org.al)

#### Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.